



POLITIKA E PARANDALIMIT TE PASTRIMIT TE PARAVE DHE FINANCIMIT TE TERRORIZMIT (PPP/LFT)

KUADRI RREGULLATOR I BANKES

Legalizimi i të ardhurave nga aktivitetet kriminale ose “Pastrimi i Parave” (në vijim PP) i referohet të gjitha aktiviteteve që synojnë të fshehin burimin e paligjshëm të fondeve. Financimi i Terrorizmit (në vijim FT) i referohet aktiviteteve të cilat kanë për qëllim kanalizimin e fondeve tek palët e treta për qëllime terroriste.

Reputacioni dhe aftësia paguese e Bankës si dhe besueshmëria e sistemit financiar në përgjithësi, mund të kenë pasoja të rënda, si rezultat i përpjekjeve të bëra nga kriminelët për të fshehur burimin e të ardhurave nga aktivitetet kriminale apo të kanalizojnë fonde për veprimtari terroriste.

Duke identifikuar rreziqet që lindin nga aktivitetet e PP dhe FT, pasojat e tyre të mundshme, rëndësinë e luftës kundë kimit financiar dhe duke marrë gjithashtu parasysh dispozitat e rekomandimeve të Grupit të Punës për Veprime Financiare (FATF) dhe të kuadrit rregullator në fuqi, Banka ka miratuar dhe zbaton Politikën e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftës Kundër Financimit të Terrorizmit (Politikën PPP/LFT). Kjo politikë është miratuar nga Këshilli Drejtues i Bankës.

Alpha Bank Albania dhe degët e saj zbatojnë Politikën AML/CFT duke u mbështetur në procedura të specializuara dhe sisteme të përshtatshme të Teknologjisë së Informacionit.

Në mënyrë më të detajuar:

Procedurat:

- Janë përshtatur me natyrën e aktivitetit të biznesit të bankës dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.
- Vlerësohen periodikisht dhe duhet të rishikohen kur identifikohen mangësi ose kur lind nevoja për të bërë rregullime.
- Miratohen nga Këshilli i Drejtues dhe duhet t'i komunikohen stafit të bankës, detyrat dhe përgjegjësitë e të cilëve janë ndarë në mënyrë të qartë.

Sistemet TI:

- Ofrojnë informacion të besueshëm dhe në kohë për kontrollin e klienteve dhe transaksioneve mbi bazën e listave të personave ose subjekteve të sanksionuara. Këto lista janë të lëshuara nga autoritete të ndryshme.
- Bëjnë të mundur monitorimin e vazhdueshëm dhe zbulimin e transaksioneve ose aktiviteteve të cilat mund të jenë të lidhur me PP apo me FT, duke përdorur parametra



specifike (tipologji transaksionesh, profilin financiar / transaksional të klientëve, aktivitetin e pritur të llogarisë etj.)

Banka ka emëruar Personin Përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në nivel drejtimi dhe administrimi. Personi Përgjegjës PPP/LTF siguron zbatimin e duhur dhe efektiv të Politikës PPP/LTF.

Politika PPP/LTF mbulon ndër të tjera çështjet e mëposhtme:

- Përgjegjësitë e Personit Përgjegjës PPP/LTF
- Politika e Pranimit dhe Bashkëpunimit me Klientët
- Monitorimi i vazhdueshëm i Llogarive dhe Transaksioneve
- Raportimi i Transaksioneve të dyshimta
- Respektimi i detyrimeve të tjera sipas Kuadrit Rregullator

PËRGJEGJËSITË E PERSONIT PËRGJEGJËS PPP/LTF

Personi Përgjegjës PPP/LTF siguron respektimin e detyrimeve PPP/LTF dhe zbatimin e duhur dhe efektiv të Politikës PPP/LTF.

Banka ka një Strukturë e vecantë PPP/LTF. Këshilli i Drejues i Bankës garanton pavarësinë e Strukturës së PPP/LTF.

POLITIKA E PRANIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KLIENTËT

Banka, në nivel grupi, zbaton një qasje bazuar në risk për të përcaktuar dhe drejtuar në mënyrë efektive riskun e produkteve dhe shërbimeve që ofron.

Parimi bazë i politikës së pranimit dhe bashkëpunimit me klientët është parimi “Njihe Klientin Tënd” (NKT), parim i cili përbën bazën e të gjitha procedurave të PPP/LTF dhe mbulon mbledhjen dhe mirëmbajtjen e informacionit efektiv për cdo klient për qëllimet e mëposhtme:

- Verifikimi dhe identifikimi i klientit.
- Vlerësimi i përgjithshëm i profilit të klientit.
- Masa specifike vigilance duke u nisur nga profili i klientit

Kriteret e përdorura për të vlerësuar klientët janë si më poshtë:

- Shfaqja e klientit në listat e sanksioneve.
- Informacioni i duhur për të verifikuar identitetin e klientit.
- Profesionin e klientit apo veprimtarinë e aktivitetit.
- Forma ligjore dhe vendi i themelimit të personave juridikë.
- Pronari përfutues apo nëse ka ndonjë kontroll efektiv mbi ndonjë person juridik.
- Vendi i origjinës së klientit apo vendi ku klienti vepron.
- Vendi i origjinës dhe destinacionit të fondeve.



- Vëllimi , madhësia dhe tipi i transaksioneve të biznesit.
- Kompleksiteti i transaksioneve.
- Përdorimi i teknologjive të reja në transaksione.
- Devijimet nga profili ekonomik / transaksional i klientit.

Kategoritë e Klientëve të Papranueshëm

- Klientët subjekt e embargove të vendosura nga vendimet e Bashkimit Europian, autoritetet kombëtare të Shqipërisë ose organizata të tjera ndërkombëtare.
- Klientët (persona fizikë ose juridikë) që nuk ofrojnë të gjithë informacionin e kërkuar për identifikimin dhe verifikimin e identitetit të tyre.
- Klientët për të cilët mbledhja e informacionit për vlerësimin e profilit të tyre të përgjithshëm është e pamundur.
- Klientët, aktivitetet ose transaksionet e të cilëve, nuk janë në përputhje me të dhënat, veprimtarinë e tyre profesionale, profilet e tyre të riskut dhe origjinën e fondeve.
- Klientët për të cilët janë paraqitur në mënyrë të përsëritur raporte të transaksioneve të pazakonshme ose të dyshimta në Njësinë lokale të Informacionit Financiar (FIU).
- Bankat Guaskë
- Kompanitë e basteve dhe të kumarit(duke përfshirë edhe kompanitë me aktivitete të ngjashme të ofruara përmes internetit) që veprojnë pa autorizim ose pa mbikëqyrje.
- Klientët që ofrojnë shërbime financiare ose të sigurimit pa autorizim ose kontroll nga një autoritet mbikëqyrës.

Kategoritë e Klientëve me Risk të Lartë (Vigjilencë e Zgjeruar)

- Klientet, subjekt të sanksionimit sipas vendimeve të Zyrës së Kontrollit të Aseteve të Huaja (OFAC), autoriteteteve kombëtare të vendeve ku kompanite janë themeluar apo organizata të tjera ndërkombëtare.
- Personat e ekspozuar politikisht.
- Kompani me aksione të prurësit.
- Shoqëritë e Transferuara dhe me qëllime të vecanta.
- Organizatat jofitimprurëse.
- Llogaritë për menaxhimin e portofolit të klientëve të rëndësishme.
- Transaksione që zhvillohen pa praninë fizike të klientit
- Marrëdhëniet bankare ndërkufitare korrespondente me vendet e treta
- Klientet jo rezident.
- Klient nga vendet që:
 - Nuk zbatojnë si duhet rekomandimet e FATF
 - Janë perceptuar të kenë nivele të larta të korrupsionit.
 - Vende te cilat konsiderohen me rrezik të lartë PP



MONITORIMI I VAZHDESHËM I LLOGARIVE DHE TRANSAKSIONEVE

Monitorimi i vazhdueshëm i llogarive dhe transaksioneve arrihet nga respektimi i procedurave përkatëse, kryesisht përmes sistemeve IT të përshtatshme. Qëllimi i monitorimit të vazhdueshëm të llogarive dhe transaksioneve është për të zbuluar transaksione të pazakonshme ose të dyshimta të cilat mund të jenë të lidhura me PP / FT.